



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**METODOLOGJIA E PUNËS SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR VLERËSIMIN E
KANDIDATËVE PËR PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Metodologjia e punës së Komisionit të Posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është dokument i brendshëm i Komisionit që synon të lehtësojë punën e tij në zbatim të rregullores Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, miratuar me Vendim nr. 51, datë 29.3.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për të siguruar një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës, me synim krijimin e Prokurorisë së Posaçme.

KREU I

HARTIMI DHE MIRATIMI I TABELAVE TË VLERËSIMIT PARAPRAK

Neni 1

Tabelat e vlerësimit të kandidatëve

1. Komisioni kërkon nga Prokurori i Përgjithshëm dy vlerësimet e fundit të performancës së kandidatëve për të bërë vlerësimin sipas nenit 5 dhe 6 të Rregullores.
2. Me propozimin e Kryetarit, Komisioni i Posaçëm miraton tabelat e vlerësimit të kandidatëve sipas kriterëve të parashikuara në nenin 9 dhe 10 të Rregullores sipas shtojcës 1 të kësaj metodologjie.
3. Vlerësimi i kandidatëve nga ana e Komisionit realizohet kryesisht mbi bazën e dokumentacionit që kandidatët kanë depozituar pranë Këshillit.
4. Komisioni rezervon të drejtën të kërkojë nga ana e prokurorive ku kandidatët ushtrojnë apo kanë ushtruar funksionin e tyre, dokumentacion shtesë.
5. Tabelat e vlerësimit paraparak përmbajnë elementët e vlerësimit të kriterit: *Aftësitë e treguara në hetim, përfshirë përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit dhe qasjen proaktive të hetimit; në ndjekjen penale, përfshirë formulimin e akuzës dhe përfaqësimin në gjykatë; dhe në konfiskimin e produkteve të veprës penale dhe të aseteve, sipas Kodit të Procedurës Penale ose ligjit antimafia (Kriteri 1) dhe të kriterit: Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti i posaçëm profesional, përfshi etikën profesionale, ndershmërinë, paanësinë, sigurinë dhe konfidencialitetin e treguar nga kandidati (Kriteri 2)*

6. Kandidatët vlerësohen për Kriterin 1 sipas këtyre elementeve: përdorimi i teknikave të posaçme të hetimit, qasja proaktive dhe aftësitë në ndjekjen penale, përfshirë formulimin e akuzës dhe përfaqësimin në gjykatë.
7. Elementet e vlerësimit për Kriterin 1 nuk janë kumulative
8. Secili prej elementeve të vlerësimit për Kriterin 1 hartohet mbi bazën e përkufizimeve të parashikuara në nenin 3 të Rregullores.
9. Vlerësimi për çdo element bazohet në numrin e çështjeve për të cilat kandidati ka dorëzuar akte proceduriale të dosjeve (vlerësim sasior) dhe veçanërisht në përmbajtjen e këtyre akteve në raport me kriteret e vendosura (vlerësim cilësor).
10. Kandidatët vlerësohen për Kriterin 2 lidhur me vendosmërinë e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti i posaçëm profesional, përfshi etikën profesionale, ndershmërinë, paanësinë, sigurinë dhe konfidencialitetin e treguar nga kandidati.
11. Komisioni, për vlerësimin e Kriterit 2 bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati ku përshkruhen çështje, situata, rrethana që dëshmojnë vendosmërinë në përballimin e vështirësive, presioneve dhe rreziqeve si dhe integritetin e posaçëm profesional.
12. Komisioni rezervon të drejtën të kërkojë dhe të marrë edhe të dhëna të tjera për të kryer vlerësimin e kandidatëve sipas Kriterit 2.

KREU II

SHORTI

Neni 2

Hedhja e shortit

1. Për trajtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët hidhet shorti mes anëtarëve të Komisionit.
2. Secili anëtar i Komisionit trajton dhe vlerëson si relator një numër afërsisht të barabartë kandidatësh me anëtarët e tjerë.
3. Shorti hidhet në prani të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe monitoruesve të Euralius dhe OPDAT.
4. Secili anëtar i Komisionit sipas rendit alfabetik tërheq fletët e mbyllura ku janë shënuar emrat e kandidatëve.
5. Pas tërheqjes së çdo flete anëtari i Komisionit e hap atë dhe lexon emrin e kandidatit që do të vlerësojë.
6. Në përfundim të procesit lexohen emrat e kandidatëve që do vlerësojë secili anëtar i Komisionit.
7. Për hedhjen e shortit mbahet procesverbali përkatës.

Neni 3

Tërheqja dhe dorëzimi i dokumentacionit

1. Secili anëtar i Komisionit tërheq pranë zyrës së protokollit të Këshillit, kopje të dokumentacionit të kandidatëve që do të vlerësojë sipas shortit.

2. Tërheqja e dokumentacionit bëhet kundrejt nënshkrimit, me një procesverbal të veçantë dhe nën përgjegjësinë e anëtarit të Komisionit.
3. Në përfundim të procesit të vlerësimit nga ana e Komisionit, anëtarët e Komisionit dorëzojnë dokumentacionin e marrë sërish me një procesverbal të veçantë.

KREU III

PROCESI I VLERËSIMIT NË KOMISIONIN E POSAÇËM

Neni 4

Vlerësimi paraprak

1. Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit të kandidatëve, secili nga anëtarët e Komisionit kryen një vlerësim paraprak sipas tabelave të vlerësimit të paraqitura në Shtojcën 1.
2. Vlerësimi paraprak i çdo anëtari për kandidatët, sipas shortit, diskutohet me anëtarët e tjerë të Komisionit.
3. Çdo anëtar i Komisionit, pasi është njohur me vlerësimin paraprak të një anëtari tjetër, ka të drejtë të kërkojë të njihet me aktet e dosjeve të kandidatëve përkatës.
4. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të bëjë pyetje, vërejtje dhe të paraqesë propozime konkrete lidhur me shkallën e vlerësimit të kandidatëve.

Neni 5

Vendimmarrja e Komisionit lidhur me vlerësimin e kandidatëve

1. Pas shqyrtimit të të gjithë vlerësimeve paraprake të përgatitur nga anëtarët e Komisionit sipas tabelave të paraqitura në Shtojcën 1, Kryetari i Komisionit hap procedurën e votimit.
2. Komisioni voton vetëm për shkallën e kualifikimit të kandidatëve sipas nenit 8 të Rregullores.
3. Komisioni voton me shumicë të thjeshtë shkallët e kualifikimit të kandidatëve në mënyrë nominale sipas rendit alfabetik.
4. Anëtari/anëtarët e mbetur në pakicë mund të propozojnë dhe argumentojnë një shkallë tjetër kualifikimi për secilin kandidat.

KREU IV

RAPORTIMI NË KËSHILL

Neni 6

Raportimi në Këshill

1. Pas miratimit nga Komisioni të shkallëve të vlerësimit për secilin kriter të parashikuar nga rregullorja, për secilin kandidat, Kryetari i Komisionit harton raportin përfundimtar dhe ia paraqet atë Kryetarit të Këshillit.
2. Kryetari i Këshillit thërret mbledhjen plenare dhe u vendos në dispozicion anëtarëve, raportin e Komisionit.

3. Nëse anëtarët e Komisionit, të mbetur në pakicë në votimin në Komision, kanë propozime konkrete lidhur me shkallët e vlerësimit për kandidatë të caktuar, ata paraqesin me shkrim tek Kryetari i Këshillit propozimin e tyre në formën e një raporti të argumentuar dhe dokumentuar.
4. Kryetari i Komisionit prezanton në mbledhjen e Këshillit një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit.
5. Me kërkesë të tij/tyre, anëtari/ anëtarët e mbetur në pakicë në votimin në Komision, mund të prezantojnë gjetjet e tyre dhe propozimet për shkallën e vlerësimit të kandidatëve.

KREU V

MONITORIMI DHE DOKUMENTIMI I PUNËS SË KOMISIONIT

Neni 7

Monitorimi nga vëzhguesit ndërkombëtarë

1. Ekspertë dhe vëzhgues të Euralius dhe OPDAT kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo mbledhje të Komisionit si dhe të kërkojnë t'u vihen në dispozicion aktet që kandidatët kanë sjellë për vlerësim.
2. Monitoruesit ndërkombëtarë mund t'i ofrojnë Komisionit ndihmën e tyre të specializuar në procesin e vlerësimit të kandidatëve.

Neni 8

Monitorimi nga Kryetari i Këshillit

1. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka të drejtë të marrë pjesë në çdo mbledhje të Komisionit si dhe të kërkojë t'i vihen në dispozicion aktet që kandidatët kanë sjellë për vlerësim.
2. Kryetari i Këshillit mund të dërgojë një përfaqësues në mbledhjet e Komisionit për të asistuar nga afër punën e tij.

Neni 9

Dokumentimi i punës së komisionit

1. Komisioni asistohet nga një sekretar, i caktuar nga Kryetari i Këshillit nga radhët e administratës së Këshillit.
2. Sekretari i Komisionit mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili, pas zbardhjes, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.
3. Në raste të veçanta, mbledhja e Komisionit regjistrohet audio.
4. Në përfundim të procesit të vlerësimit, dokumentacioni i mbledhjeve të Komisionit dorëzohet dhe ruhet në arkivën e Këshillit.